



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3676

NR. VENDIMI 7834

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e përbërë nga;

GJYQTARE: REGLETA PANAJOTI

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Irena Rafti** sot me dt. **01.10.2018** mbaroi së shqyrtuari ne seance gjyqesore publike ceshtjen civile me Nr. 3676 Akti, qe i perket:

PADITES : Shoqëria tregtare “****” shpk rregjistruar si person juridik ne dt. **, me seli ne **, me përfaqësues z. ** përfaqësuar në gjykim ne bazë të prokures me nr. ** nga av. ** me nr. ** license.
TE PADITUR : 1-**i dtl **, lindur e banues ne **, përfaqësuar në gjykim ne bazë të prokurës së posacme me nr ** nga av. ** me nr ** license (ne shpallje ne mungese).

2-Personi Fizik **rregjistruar ne dt **me nr NIPT ** me vend te ushtrimit te aktivitetit ne **, përfaqësuar në gjykim ne bazë të autorizimit te përfaqësimit me nr ** prot dt **nga av. **me nr ** license si dhe ne bazë të prokurës me nr ** nga av. **me nr ** license av. **me nr ** license (ne shpallje ne mungese).

PERSONA TE TRETË : 1- Drejtoria e Përgjithshme e Pronesise Industriale Tiranë(DPPI) , (ne mungese).

2-Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare AKEP me seli ne Tiranë Rr.”Reshit Collaku” Tiranë , përfaqësuar në gjykim ne bazë të autorizimit te përfaqësimit me nr ** dt ** nga znj ** dhe z. ** (ne shpallje ne mungese).

OBJEKTI I PADISË : -Ndalimi i përdorimit te emrit te domain “****”;
-Transferimin e ketij domain ne emer te paditesit shoqërisë tregtare “****” shpk.

-Urdherimi i palës së paditur ti paguajne mbajtesit te se drejtes tarifat e nevojshme për ndjekjen gjyqesore te ceshtjes .

-Publikimin e vendimit përfundimtar te Gjykatës ne median publike me shpenzime e personit që ka kryer shkeljen ne menyren e parashikuar nga Gjykata .

-Ndalimin e te paditurve te përdorin emrin ** si emer tregtar apo ne korrespondenca biznesi .

-

BAZA LIGJORE: Neni 638 , 639 i K.Civil. Ligji “Per pronesine industriale” Neni 4/17, 156, 184 /2 e vijues.

Gjykata pasi, administroi provat shkresore dëgjoi pretendimet përfundimtare të përfaqësueses të palës paditëse e cila kërkoi: Pranimin e kërkesë-padisë, si te bazuar në ligj dhe prova. Përfaqësueset e palës së paditur që kërkuan rrezimin e kërkesë-padisë, personit te tretë AKEP përfaqësuesit e te cilit e lane ne vleresim dhe cmim te Gjykatës zgjidhjen përfundimtare të çështjes, në përfundim te gjykimit ne mungese te DPPI, si e bisedoi çështjen në tërësi.

VEREN :

Se, pala paditëse, shoqëria tregtare “****” shpk “ shoqëri me përgjegjesi te kufizuar është rregjistruar si e tille që nga data *** sipas ekstraktit te rregjistrimit te kesaj shoqërie te leshuar nga QKB . Ajo ka ne objekt te aktivitetit te saj tregtar kryesisht ne fushen e import eksportit , përpunim dhe tregtim me shumice dhe pakice te kafese dhe nenprodukteve te saj , bar kafe , ne fushen e turizimit , te hapjes se hoteleve , etj. Pala paditese nepermjet perfaqesueses se saj ka paraqitur përpara kësaj gjykatë kërkesë-padinë me objekt të saktësuar si me sipër cituar ne kete vendim. E paditura znj *** ka statusin e personit fizik e rregjistruar si e tille ne dt *** nen emrin tregtar “****” .Ne objektin e saj tregtar e paditura znj .*** kryen kryesisht aktivitet ne fushen e veprimtarise portali online . Ndërsa z. *** eshte ne kete gjykim ne cilesine e bashke te paditurit ne kushtet kur ne momentin e aplikimit për domain name prane AKEP, e paditura znj *** ka deklaruar si përfaqësues ligjor te ketij portali z. ***.Te paditurit zoterojne domain name “**** i rregjistruar si i tille nga dt *** prane AKEP. Rezulton gjithashtu se te paditurit janë konfirmuar dhe rregjistruar si mbajtës te domain *** nga data *** me periudhe rregjistrimi dy vite prane AKEP sipas ekstraktit te leshuar nga ky institucion prove kjo e administruar ne dosje gjyqësore .

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare që këtu e ne vijim do te shenohet ne kete vendim AKEP ka statusin e personit juridik publik jo buxhetor e krijuar sipas Ligjit nr 9918 dt19.05.2008 ” Për Komunikimet Elektronike ne RSH“ i ndryshuar .

Në cilësinë e personit te tretë ne kete gjykim eshte thirrur nga paditesi edhe Drejtoria e Përgjithshme e Pronesise Industriale (që këtu e në vijim mund të shënohet edhe DPPI Tiranë) .

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesë-padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Në bazë të Neneve 36/1 dhe 59 të K. Pr. Civile, gjykata pasi shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore në bazë të Nenit 348 të K. Pr. Civile, “Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat , markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot tregtare , modelet dhe cdo e drejte tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare ne Gjykatën e Shkallës së Parë Tranë sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod”.

Po kështu në nenin 4 të Ligjit nr 9947 dt 07.07.2008 “ Për pronësinë industriale “neni 14 pika 7 është rregulluar se :”Gjykatë” është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë “ . Megënëse ndodhemi përpara kërkesë-padisë me objekt gjykimi në fushën e markave tregtare e të drejtave që burojnë prej tyre gjykata konstaton se nga pikëpamja lëndore është kompetente për shqyrtimin e çështjes.

Paditësi në bazë të Nenit 31 dhe 32/a të K. Pr. Civile, legjitimohet t'i drejtohet gjykatës me këtë kërkesë-padi, në bazë të së cilës do të përfitojë të drejta pasurore juridiko-civile.

Gjate gjykimit të ceshtjes Gjykata si shqyrtoi kërksat e palës paditese mbi rregullim të ndergjygesise (AKEP të thirrej ne cilesine personit te trete dhe Znj *** ne pozicionin e bashke te paditurit) ne aplikim te nenit 161 dhe 184 te K.Pr.Civile si mori dhe pohimin e paleve i pranoi ato .

Në bazë të Nenit 35 të K. Pr. Civile, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Rrethanat e faktit

Shoqëria paditese” ****“ shpk ushtron aktivitetin e saj tregtar kryesisht në aktivitetin e import eksportit , perpunim dhe tregtim me shumice dhe pakice te produkteve te kafese ,ne fushen e zhvillimit te turizmit , hapjes se hoteleve , restoranteve , bar restorante, etj .Paditesi shoqëria tregtare ****“shpk është njëkohësisht pronare e markave tregtare ****“.Pala paditëse shoqëria tregtare ****“ shpk ka të rregjistruar në cilësine e pronarit te markave dhe gezon te drejten e mbrojtjes në RSH të markave të rregjistruara si më poshtë :

Marken *** (me ngjyre te mbrojtur te zeze) me nr *** me datë depozitimi *** e mbrojtur deri ne dt. *** me listë të mallrave dhe /ose shërbimeve , kafe ekspres, kafe turke , kafe dekafeinato, kakao , mallra në klasën e 30-te sipas klasifikimit ndërkombetar të Nicë ; Kjo marke prone e pales paditese eshte pajisur me certificate ripërteritje regjistrimi marke nga DPPI ne dt *** me nr *** prot;

Marka *** me nr *** me datë depozitimi *** në emër të të njëjtit pronar shoqëria tregtare ****“ shpk me liste te mallrave dhe shërbimeve në klasën e 43-te për sherbime vende akomodimi, hotele , pensione , motele , shtepi turizmi , bar dhe restaurant , akomodimi , hoteleri etj e mbrojtur deri ne dt ***.

Marka *** me nr *** dt ***me datë depozitimi *** në emër të të njëjtit pronar me liste te mallrave dhe shërbimeve në klasën e 43 për sherbime akomodim, hotele , pensione , dhenia me qera e akomodimeve te perkohshme sherbime baresh , kafene , Kantina , catering etj, e mbrojtur deri ne dt ***.Rezulton gjithashtu sipas deshmise se depozitimit me nr ***dt ***te DPPI dhe kerkeses bashkalidhur saj te depozituar ne dt ***se paditesi ka aplikuar per listen e mallrave dhe sherbimeve per te cilat kerkohet mbrojtja nen marken *** edhe per mallrat e sherbimet ne klasen e 35 te klasifikimit te Nices .Ne kete klase perfshihen reklama me cdo mjet reklamues , marketin , ofrim I informacionit tregtar etj.

Sipas markave prone të paditësit te rregjistruara edhe në rregjistrin e markave dhe patentave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronesise Industriale në RSH këto marka janë të rregjistruara për listen e mallrave dhe sherbimeve (sipas klasifikimit ndërkombetar të Nicës) ne klasat 30 dhe 43 dhe ka aplikuar per mbrojtje edhe ne klasen e 35. .

Në certifikatat e rregjistrimit të markave janë rregjistruar edhe shenja dalluese e përfaqësimit të markave *** ku shkrimi eshte me shkronja kapitale me ngjyre te zeze dhe pasqyrimi i markes *** me sfond te zi , shkronja kapitale ne te bardhe dhe nenvizim siper dhe poshte fjaleve *** .

Pala e paditur personi fizik *** është subject i të drejtës tregtare shqiptare i rregjistruar si person fizik me fushe veprimtarie te rregjistruar pranë QKB portal

online nen emrin tregtar ***. E paditura *** ka aplikuar prane AKEP per domain name “*** “me subject aplikues personin fizik *** dhe përfaqësues ligjor te paditurin ***. Në saje te komunikimit elektronik konfirmohet pranimi i rregjistrimit te domain name *** me date rregjistrimi *** dhe periudhe rregjistrimi dy vjecare .Domain elektronik, *** sipas pohimit te perfaqësueses ofron sherbime ne fushen e sherbimeve te përcaktuara ne klasen 35-te te tilla si reklamime , marketing , ofrimi i informacionit tregtar ne te gjitha mjetet publike , administrimi i biznesit te barit , restorantit , hotelit , funksion zyre , reklame te produkteve te kafese dhe te ngjashme me to etj .

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare që këtu e ne vijim do te shenohet ne kete vendim AKEP ka statusin e personit juridik publik jo buxhetor e krijuar sipas Ligjit nr 9918 dt19.05.2008 ” Për Komunikimet Elektronike ne RSH“. Sipas nenit 3 /2 te ketij ligji eshte përcaktuar se :

“...2. “Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare” (më poshtë AKEP) është organi rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. ...”
Po kështu ne nenin 6 te ketij Ligji eshte parashikuar forma juridike dhe kompetencat e AKEP , duke parashikuar se :

“1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. AKEP-i është një person juridik, publik, jobuxhetor, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP-i në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur. AKEP-i e ka selinë në Tiranë....”

Pretendimet e palëve :

Paditesi pretendoi ne kete gjykim se :

Në përputhje me nenin 156/2/b të Ligjit nr 9947 dt 07.07.2008 pronari ka te drejtë të ndaloje personat e tretë të përdorin gjatë ushtrimit te veprimtarisë së tyre tregtare pa autorizimin e pronarit te markës një shenje , që është e njëjte apo e ngjashme me marken prone të tij apo që për shkak të llojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave dhe shërbimeve për të cilat përdoret shenja , me mallrat apo shërbimet , që mbulohen nga markat e rregjistruara apo që mund te shkaktojne konfuzion te publiku ku përfshihet edhe mundesia e bashkëlidhjes së shenjes me marken tregtare.Paditesi per te provuar statusin e markes së mirnjohur ne kuptim te dispozitave te Ligjit nr 9947 dt dt 07.07.2008 si marka që përfitojne mbrojtje me te zgjeruar ka depozituar te dhena zyrtare lidhur me shpenzimet që pronari I tyre shoqëria tregtare “***” shpk kryen për llogari te promovimit te markave tregtare *** si dhe përdorimin e saj masiv ne treg .Me cilesine e proves shkresore pala paditese depozitoi vetdeklarimet te shpenzimeve te deklaruar nga kjo shoqëri tregtare mbi marketingun e markes pronare te te cilave ato jane dt 14.05.2018 . Po kështu ne cilesine e provave u depozituan prova fotografike te mallrave te tregtuara nen marken *** te tilla si :gota plastike ,duhanshkundese, filxhane kafeje , kapucino ,filxhane caji, canta , trazues te mbeshjtjelle, paketa sheqeri per kafe , set cajnik dhe filxhan , filxhane qumeshti, gota qeramike me veshje silikonit dhe kuti, etj .

Pala e paditur (sipas pretendimeve te paditësit) pas disa hetimeve te kryera nga paditesi rezulton te jete poseduese e rregjistruar e domain *** I cili eshte identik me marken e mirnjohur *** dhe se e paditura *** e ka rregjistruar kete emer ne emrin

e saj prane AKEP pa autorizimin e mbajtesit ligjor te markes *** . Paditesi pretendon se , pala e paditur e përdor kete domain për të publikuar aktivitetin e saj tregtar ne fushen e informacioneve ku përfshihen si reklama te ndryshme te aktiviteteve që I përkasin mallrave dhe sherbimeve te kafese , barit , kafenese , etj
Paditesi pretendon se , përdorimi I domain name “*** .al dhe paraqitja e kërkesës për rregjistrim te tij para AKEP si te veten ne menyre haptazi te paligjshme te termit *** e ben aktivitetin e palës së paditur të jetë I paligjshem , pasi cenon të drejtat e pronesisë industriale të paditësit të cilat ndalojne palët e treta të përdorin një markë tregtare ne veprimtarine tregtare , reklamime ose publicitete .Me keto veprime pala e paditur ka shkelur nenin 156 pika 3 te ligjit 9947 dt 07.07.2008 si dhe nenet 4 dhe 18 te rregullores nr 02 dt 21.02.2008 “Për rregjistrimin dhe administrimin e emrave te domain-eve nen AL dhe nen domainet gov.al, mil.al, edu.al.com.al, org.al dhe net.al . Përvec kesaj I padituri e përdor emrin e domain-it ne veprimtarine e saj tregtare dhe ne kete menyre ajo ka shkelur te drejten që rrjedh nga rregjistrimi I markes tregtare te rregjistruar dhe te mbrojtur ne RSH .

I padituri , përmes përdorimit te shenjave dalluese , sic janë ato të markes *** sjell ngatëresë e konfuzion në rradhet e konsumatoreve , të cilët kujtojne se nje biznes I tillë I të paditurve behet me autorizim ose me license të lëshuar nga pronari I markes , paditësi , duke shkaktuar në këtë mënyrë një konkurrencë të pandershme përfitim nga reputacioni dhe emri I mire I ngritur nder vite nga pronari I markes së mirnjohur *** ne Shqipëri . Paditesi pretendon se pala e paditur ka konsumuar edhe elementet e konkuresces së pandershme ndaj shoqërisë paditese , duke shkelur ne kete menyre nenin 638 të K.Civil .

Ne kuptim te nenit 4.2 dhe 18.2 te rregullores se miratuar pala e paditur duhet te mbaje përgjegjesi ligjore për cenimin apo shkeljen e te drejtes se pronesisë intelektuale si dhe ligjin e konkuresces si dhe sjelljet jokorrekte ne marredhenie tregtare .Si rrjedhoje pala paditese I ka kërkuar me shkrim te paditurve te nderpresin apo te pushojne cenimin e markes *** duke e rregjistruar emrin e domain *** dhe transferimin e ketij domain ne emer te paditesit .

Për paditesin rregjistrimi nga te paditurit si emer domain I markes se rregjistruar *** ashtu dhe përdorimi I kesaj marke ne faqen e ëeb-it nga I padituri për të reklamuar dhe ushtruar aktivitetet tregtar ne fushen e informacionit dhe reklames , përbejne shkelje te se drejtes së markes ne kuptim te nenit 156 pika 3 e ligjit 9947 dt 07.07.2008

Pala e paditur e prapësoi kërkesëpadine ne teresi duke pretenduar se :

Ne dt *** është rregjistruar prane QKB subjekti *** person fizik nen emrin tregtar *** ne fushen e veprimtarise portali online . Konform përcaktimeve ligjore eshte kryer aplikim për domain name *** me subject aplikues *** dhe përfaqësues ligjor z. *** , ne fushen e sherbimeve te klases nr 35-te sipas listimit te Nices .

Për të paditurin është evident fakti I popullaritetit te portalit online *** I cili aktualisht ka nje numer te madh ndjekesish ne platformen instagram .Lista e sherbimeve mbi te cilat është rregjistruar domain name *** është e ndryshme nga lista e sherbimeve te cilat përfaqësohen dhe ofron marka *** marka te rregjistruara ne klasen 30 te sherbimeve kafe , ekspres, kafe turke , kakao , kafe dekafeinato .

Evident është fakti i popullaritetit të portalit Online: *** i cili aktualisht ka vetem ne Instagram *** ndjekës; I padituri prapeson se Gjykata nuk mund te lejoje konkurencen e pandershme ne saj te perfitimit nga perdorimi i emrit dhe popullaritetit te portalit; duke parandaluar ne kete menyre mosmarrveshjet tregtare te cilat konsistojne ne shkeljen e nje te drejte te mepareshme, ne fushen e pronesisë

intelektuale.

Në rastin konkret pala paditëse përfaqësuar nga avokatia e licensuar në regjistrimin e markave, me datë *** kërkon të regjistrojë domain name ***, në ofrimin e shërbimeve sipas klasës 35, në të cilat përfshihen: “Reklamim, reklama me cdo lloje mjeti reklamues, marketing, ofrim i informacionit tregtarë në të gjitha mjetet publikuese, duke përfshirë internetin, orgazim eventesh për qëllime propocionale, manaxhim i biznesit, administrim i biznesit të barit, restorantit, hotelit, funksione zyre, konkretisht organizim ekspozitash për qëllime tregtare ose reklamë të produkteve të kafesë dhe të ngjashme me to, ushqimeve dhe pijeve, veshje për vitrinat e dyqaneve dhe bareve, restoranteve dhe hoteleve, prezantim i mallrave nëpërmjet mjeteve të komunikimit për shitje më pakicë të produkteve të kafesë dhe të ngjashme me to, si dhe pijeve dhe ushqimeve, rrjet dyqanesh për shitje me pakicë dhe shumicë të produkteve të kafesë dhe të ngjashme me to, pijeve dhe ushqimeve”; listë shërbimesh në të cilën bën pjesë edhe subjekti “****”.

I padituri prapëson se , lista e shërbimeve mbi të cilat është regjistruar domain name “****” është e ndryshme nga lista e shërbimeve të cilat përfaqëson dhe ofron Marka ***, marke e regjistruar me date ***, në klasën 30 e cila ofron shërbime “Kafe ekspres, kafe turke, kafe dekafeinato, kakao”. Ndodhur në këto kushte, domain name “****” është regjistruar më parë në klasën e shërbimeve nr. 35 sipas shërbimeve të sipërcituara; Supozimi i cënimit të markës nuk mund të prevalojë mbi të drejtën e zotërimit të domain name, në listën e shërbimeve në faqën online, që operon në këtë domanin. Në rastin konkret fakti që shërbimet e ofruara në klasën 35-e në të cilën figuron domain name “****”, ndryshojnë nga shërbimet e ofruara në klasën nr. 30 e nr. 43 , le pa vlere pretendimin e pales paditese .

Regjistrimi i domain name “****” është kryer conform përcaktimeve ligjore, nëse do i referoheshim precedenteve ne situatë të ngjashme, blerja e një domain name cënues (ashtu sic në mënyrë indirekte nga paditësi pretendohet, paditës i cili në objektin e padisë, tejkalon të drejtën duke kërkuar transferimin në emër të palës paditëse, të “****”) paraprin qëllimin e blerësit për shitjen e këtij të fundit në poseduesin e Markës. De fakto, në vullnetin e brendëshëm dhe atë të shfaqur domain name “****”, nuk është pjesë e kësaj skeme.

Në të dhënat e publikuara pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Pronësisë Industriale, rezulton se Marka *** është depozituar me datë *** dhe është regjistruar më ***, në listën e shërbimeve sipas klasës 30; më datë 07.04.2014 është depozituar dhe regjistruar me datë ***Marka *** në listën e shërbimeve sipas klasës 43 (vende akomodimi, hotele pensione, etj.) .Ndodhur në këto kushte i padituri prapëson se asnjëra prej tyre nuk ofron shërbimet e ofruara në klasën nr. 35, në të cilën është pjesë domain name “****”.

I padituri prapëson se ëeb “****”, është faqe zbavitëse reklamuese / gossip / jetesa e personave të njohur etj. dhe jo reklamim i shërbimeve që i përkasin mallrave dhe shërbimeve të kafesë, barit, kafenese.Në shërbimin e ofruar ne domain “****” paraqitja grafike, stilizimi dhe ngjyrat e përdorura janë qartësisht të ndryshme dhe këto ndryshime rrënjësore nuk cojnë në konfondim të konsumatorit të “kafesë” .

Regjistrimi I domain *** është kryer ne respektim te ligjit . Ajo është nje faqe zbavitese reklamuese/gossip /jetesa e personave te njohur etj dhe jo reklamim I sherbimeve që I përkasin mallrave dhe sherbimeve te kafese , barit , kafenese.Në sherbimin e ofruar ne domain *** paraqitja grafike , stilizimi dhe ngjyra e përdorur jane qartesisht te ndryshme dhe keto ndryshme rrenjesore nuk cojne ne konfodim te konsumatorit te kafese .

Kjo palë kërkoj rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur ne ligj e prova .

Përfaqësuesit e personit të tretë AKEP Tiranë e lanë zgjidhjen e çështjes në vlerësim e cimit të Gjykatës .Përfaqësuesit i parashtruan Gjykatës se bazuar në nenin 8 të Germa k e Ligjit nr 9918 dt 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike “i ndryshuar AKEP administron domain cc.TLD.al, nën domainet e tij si dhe ENUM . AKEP gjatë procesit të regjistrimit vepron në mirëbesim mbi bazën e parimit të vetdeklarimit duke marrë të mirqenë vertetesinë , saktësinë , autencitetin, origjinalitetin , dhe ligjshmerinë të dhenave të paraqitura nga aplikuesi për regjistrimin e emrit të domain për të cilin aplikohet duke disponuar në çdo kohë të drejtën e verifikimit të tyre në rast dyshimi , ankimit ose veprimit rutine nga ana e tij .

Në rast cenimi haptazi të së drejtës ligjshmerise ose në rastet e përdorimit të paautorizuar prej tij të shërbimeve të parashikuara në rregullore, AKEP vepron sipas rregullores duke mos pranuar aplikimin ose mbyllur emrin e domain në përdorim . Selektimi /përzgjedhja nga ana e AKEP behet sipas kohës së depozitimit të aplikimit të vlefshemerise në përputhje me parimin kush aplikon i pari shërbehet i pari . Në bazë të këtij parimi është bërë edhe regjistrimi i domain ***. Emri i këtij domain nuk rezulton në emrat e domain-ve të ndaluar apo të rezervuar dhe nuk rezulton të jetë kërkuar nga një aplikues tjetër përpara datës së regjistrimit për të paditurin .

Analiza juridike

Gjykata si analizoi në teresi pretendimet e ndërgjygesve , nisur nga këto fakte Gjykata si administroi edhe provat shkresore cmon se kërkesëpadia mbështet në ligj e prova dhe si e tillë duhet të pranohet .

Në nenin 140 të Ligjit nr 9947 dt 07.07.2008 “ Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar është parashikuar se :

“Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta:

a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik;

b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.

Në nenin 144 të po këtij ligji është rregulluar se :

“E drejta ekskluzive për markat , sipas këtij ligji , fitohet nëpërmjet regjistrimit të tyre në DPPM .”.

Në nenin 156 të Ligjit të sipërcituar është rregulluar se :

1. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

2. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:

a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;

b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare;

c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka

ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës.

3. Në përputhje me pikën 2 të këtij neni, gjithashtu, ndalohet:

a) vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre;

b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime;

c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë;

c) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë;

d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

4. Të drejtat, që i njihen pronarit të markës së regjistruar, sipas këtij neni, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “ç” të pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji.

Po kështu Gjykata e cmon te citoje edhe shpjegimet për termat e vecante te përdorur ne Ligjin nr 9918 dt19.05.2008 ” Për Komunikimet Elektronike ne RSH“.

Sipas nenit 3 te këtij Ligji janë përcaktuar terminologjia disi specifike e termave te përdorur nga ligjvenesi ne kete akt ligjor . Kështu përcaktohet se :

-“Akses” është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një sipërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Aksesin, ndërmjet të tjerash, përfshin akses në elementet e rrjetit dhe fasiliteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin akses të hapur në rrjetin lokal dhe akses në fasilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); akses në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; akses në sistemet e softëare-ve përkatëse, përfshirë sistemet mbështetëse operacionale; akses në përkthimin e numrit (number translation) apo në sistemet, që ofrojnë funksionalitet të njëvlefshëm; aksesin në rrjetet fikse apo të lëvizshme, në veçanti për roamingun; aksesin në shërbimet e rrjeteve virtuale.

Sipas Rregullores Nr. 02 datë 21.02.2008 per “ Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, akt nenligjor i dale ne zbatim te ligjit dhe miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr.437, Datë 21.02.2008, ndryshuar me VKD nr. 1299, dt. 11.6.2010 ,VKD Nr.1396 datë 28.08.2010 , VKD nr. 2252, date 23.01.2013, Nr. 2513, datë 06.11.2014, ka te përcaktuar edhe se :

“Autoriteti Përgjegjës” - është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike (AKEP) sipas ligjit nr.9918, datë 19.05.2009 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili do të bëjë regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, si dhe mbikqyrjen e zbatimit të Rregullores nga subjektet e autorizuar prej tij për të bërë regjistrime të këtyre domain-eve dhe nën domaineve.

“aplikuesi” – është çdo person juridik publik dhe privat, çdo person fizik tregtar, si dhe çdo person natyror, i cili paraqet tek Autoriteti Përgjegjës kërkesën për regjistrimin apo transferimin e një ose më shumë emra domain-esh”.

“DNS” – Domain Name System (sistem/shërbim i emrave të domain-eve), është një bazë të dhënash e shpërndarë që përdoret për regjistrimin e burimeve të Internetit (kompjuter, router, etj) në formën e një emri domain-i (p.sh. nic.al) dhe i përputhet ato me një adresë Interneti. Si rrjedhim, protokollin e Internetit kryen konvertimin midis emrit të domain-it dhe adresave të Internetit të makinave të lidhura në Internet.

“emri domain-i” – është një kombinim alfanumerik që përbëhet nga një rrënjë dhe një shtesë që përputhet me një adresë Interneti.

Posedues të një ose disa emra domain-esh në zonën “.al”, kanë të drejtë të jenë personat juridik publikë dhe privat, personat fizik tregtar, si dhe personat natyrorë, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore. Posedues të një ose disa emra nën domain-esh në zonën “.al” : “.com.al, .org.al dhe .net.al”, kanë të drejtë të jenë personat juridik publikë dhe privat dhe personat fizik tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore”

Poseduesi i emrit të domain-it, merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që lidhen me regjistrimin, përdorimin dhe kryerjen e veprimeve me një emër domain-i në përputhje me kushtet dhe detyrimet e parashikuara në këtë Rregullore.

Aplikuesi ka të drejtë të zgjedhi si emër domain-i çdo lloj emri që dëshiron, përveçse atyre emrave që bëjnë pjesë në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar dhe të atyre që janë regjistruar më parë nga subjekte të parashikuara në Rregullore. Aplikuesi merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të rrjedhin për këtë zgjedhje,

Lidhur me zgjedhjen e emrit të domain-it/ve, aplikuesi është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet dhe kushtet e parashikuara në Rregullore. Detyrimisht duhet që emri i zgjedhur të plotësojë këto kushte :

- a) Emri të mos jetë në listën e “emrave të ndaluar” ;
- b) Emri të mos jetë në listën e “emrave të rezervuar”;
- c) Emri të jetë në përputhje me rregullat sintaksore (Neni 20);
- d) Emri të mos çënojë të drejtat e palëve të tjera, në veçanti:

i. Të drejtën e autorit (prona letrare dhe artistike dhe/ose prona industriale)

ii. Ligjin e konkurrencës dhe sjelljet korrekte në marrëdhëniet tregtare/biznesit; ...”

25.1 Autoritetit Përgjegjës bllokon emrin e domain-it në çdo rast që identifikon një shkelje të kushteve apo kritereve të përcaktuara në këtë Rregullore, sipas rasteve të mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

... c) Në rastin e një vendimi gjyqësor që urdhëron bllokimin e emrit të domain-it, mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar siç është përshkruar në nenin që lidhet me transferimin e detyruar të një emri domain-i, etj...”

30.1 Autoriteti Përgjegjës do të kryejë një transferim të detyrueshëm të emrit të domain-it në kushtet e:

a) Ekzekutimit të një vendimi përfundimtar gjyqësor ose arbitrazhi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjykata konstaton se paditesi në cilësinë e personit të interesuar dhe pronarit të markave të regjistruara *** legjitimohet të ngrejë padinë objekt gjykimi conform nenit 156 të ligjit dispozitë kjo e sipërcituar .Rezultoi e provuar gjatë gjykimit të kesaj ceshtje se i padituri *** është regjistruar si person fizik nën emrin tregtar ***. Po kështu rezultoi se ka zgjedhur të emertoje emrin e domain-it (domain name) dhe portalit të saj online *** . Përdorimi i të njëjtit emertim me marken e mbrojtur dhe certifikuar nga pala paditese (fjala ***) *** (kur rezultoi i njëjti emer me atë të markes së regjistruar të paditesit) si emertim tregtar apo emertim i domain të regjistruar pranë AKEP pa autorizimin e pronarit të markes përben cenim të së drejtës të mbrojtur nga Ligji . Përdorimi i shenjave dalluese , markave prone të paditesit, rezultoi e përdorur kryesisht nga të paditurit në formën zgjedhjes së emertimit të domain name për realizimin online të reklamimit dhe publicitetit të aktivitetit të tyre tregtar . Gjykata arrin në këtë konkluzion mbështetur në provat shkresore dhe fotografike që depozituan ndërgjyqësit dhe AKEP .

Po kështu Gjykata mban parasysh edhe faktin se të paditurit ofrojnë në objekt të aktivitetit të tyre tregtar edhe shërbime për mallrat të klasës së shërbimeve dhe

mallrave që mbrohen nën marken e paditesit të kualifikuara në klasën 35-të të tilla si: “Reklamim, reklama me çdo llojë mjeti reklamues, marketing, ofrim i informacionit tregtarë në të gjitha mjetet publikuese, duke përfshirë internetin, organizim eventesh për qëllime promovionale, manaxhim i biznesit, administrim i biznesit të barit, restorantit, hotelit, funksione zyre, konkretisht organizim ekspozitash për qëllime tregtare ose reklamë të produkteve të kafesë dhe të ngjashme me to, ushqimeve dhe pijeve, veshje për vitrinat e dyqaneve dhe bareve, restoranteve dhe hoteleve, prezantim i mallrave nëpërmjet mjeteve të komunikimit për shitje me pakicë të produkteve të kafesë dhe të ngjashme me to, si dhe pijeve dhe ushqimeve, rrjet dyqanesh për shitje me pakicë dhe shumicë të produkteve të kafesë dhe të ngjashme me to, pijeve dhe ushqimeve”; listë shërbimesh në të cilën bën pjesë edhe subjekti “****”.

Gjykata citon se, si përmbledhje e arsyes pse nevojitet ligji për markat tregtare në një ekonomi të tregut, Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara është shprehur në një prej rasteve që ka shqyrtuar se: "...Ligji për markat tregtare, duke parandaluar të tjerët nga kopjimi i një marke që identifikon një burim, zvogëlon shpenzimet e një konsumatori kur del për të blerë dhe kur vendosë çfarë të blejë, sepse e siguron atë që ky mall – me markë të caktuar – prodhohet nga i njëjti prodhues sikurse edhe produktet e tjera me markë të ngjashme të cilat këtij konsumatori i kanë pëlqyer, ose jo, në të kaluarën. Njëkohësisht, ligji ndihmon duke e siguruar prodhuesin se ai (e jo konkurrenti imitues) do të korrë shpërblimet financiare dhe reputacionin e mirë lidhur me një produkt të dëshirueshëm." Qualitex Co. kundër Jacobson Products Co, Gjykata Supreme e ShBA (1995)."

Situatë e këtij gjykimi, krijon tek të tretet një ngatërresë në rradhet e konsumatoreve shqiptare por edhe të huaj të cilët krijojnë përshtypjen e gabuar se të paditurit personi fizik R.Sejdiu dhe personi i autorizuar prej saj si përfaqësues z. E. Kapxhiu në portalin online *** janë pajisur me autorizim apo janë autorizuar në përdorim të markes së paditesit. Reklamimi i shenjave dalluese të markave prone të paditësit në reklamim të aktivitetit tregtar të palës së paditur, pa asnjë ndryshim, lidhur me aktivitetin kryesor të tij mbi reklamim të shërbimeve të mbrojtura në klasën e 35 të shërbimeve me të drejtë ka shqetësuar paditesin i cili provoi në këtë gjykim cenimin e të drejtës së pronësisë industriale.

Gjykata nga tërësia e shqyrtimit gjyqësor konkludon se ekzistojnë kushtet ligjore për të urdheruar ndalimin e të paditurit të ofrojë shërbime me markat prone të palës paditëse, në kushtet kur rezultoi e provuar se i padituri ka përdorur pikërisht shenjat dalluese të këtyre markave në veprimtarinë e tij tregtare, në reklamime dhe publicitete të aktivitetit të tij tregtar. I binte barra e provës palës së paditur conform nenit 12 të K.Pr.Civile të provonte Gjykatës se përdorimi i shenjave dalluese (vizatimeve apo fjaleve) që përbejnë në vetvete markat "****" të vendosura në emertimin e domain name të palës së paditur *** në aktivitetin tregtar që ushtron i padituri janë pikërisht në respektim të nenit 156 të Ligjit nr 9947 dt 07.07.2008.

Përdorimi i të njetit emertim tregtar ***, zgjedhja e emertimit të domain name *** për aktivitetin tregtar të të paditurve, përdorimi i shenjave dalluese të markave "****", nuk u mohuan në këtë proces as nga përfaqësuesi i palës së paditur. Gjykata nuk i gjen veprimet e palës së paditur në përdorim të markave prone të paditësit në reklamim të aktivitetit të tij në kategorinë e veprimeve që përjashtojnë mbrojtjen e pronarit të markes sipas nenit 157 të Ligjit "Për pronësinë industriale".

Në përfundim të gjykimit Gjykata si respektoi me korrektesë të gjitha kërkesat e legjislacionit procedural civil konkludon për të gjitha arsyet e përmenduar më lart në pranimin e kërkesëpadisë.

PER KETO ARSYE:

Gjykata, bazuar në Nenit, 126, 306 e vijues të K. Pr. Civile,

VENDOSI:

-Pranimin e kerkespadiisë si të mbështetur në ligj dhe në prova.
-Detyrimin e të paditurve solidarisht * dhe Personi Fizik *** të ndalojnë përdorimin e domain-it, “***.rregjistruar dt.***prane AKEP.**
-Urdherimin e Autoritetit Pergjegjes te krveje transferimin e detyrueshem te emrit te domain-it, “*.al” i rregjistruar ne emer te te paditurve *** dhe Personi Fizik *** ne dt.***, ne emer te shoqerise “***” shpk, ne aplikim te nenit 30 e vijues te Rregullores miratuar me vendimin nr 437 dt 21.02.2008 te ERT (te ndryshuar).**
-Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim solidarisht të të paditurve .

-Urdherohet publikimi i ketij vendimi ne median publike me shpenzimet solidarisht te te paditurve, ne referim te nenit, 184/3/ç te ligjit Nr.9947 dt 07.07.2008“Per Pronesine Industriale”.
-Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane, duke filluar ky afat per palen prezent nga dita e neserme e shpalljes se vendimit, per palet ne mungese, ky afat fillon nga e nesermja e komunikimit te vendimit .

U shpall ne Tirane ne daten 01.10.2018

SEKRETARE

GJYQTARE

IRENA RAFTI

REGLETA PANAJOTI

-

Shpenzime gjyqësore

Taksë padie 3000 Lekë

Shpenzime avokatie 1020 Euro

Shpenzime njoftimi 2100 Leke

-